

Prishtinë, 15.08.2014

## Kontributi i shoqërisë civile në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën 2014

Emri i organizatës: **Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Prishtinë, Kosovë**

Kontributi për: **Kriteret Politike**

**2.1 Demokracia dhe sundimi i ligjit**

**2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave, të drejtat civile dhe politike**

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) rregullisht jep kontributin e vet me shkrim për Raportin e Progresit të KE-së për zhvillimin e shoqërisë civile, si dhe për marrëdhëniet në mes BE-së dhe Kosovës, në veçanti për strukturat për bashkëpunim në mes institucioneve të Kosovës dhe shoqërisë civile. Kontributi i këtij viti mbulon zhvillimet **nga tetori 2013 deri në fund të korrikut 2014**, përderisa thekson elementet kryesore të politikave ekzistuese dhe kornizës ligjore, të cilat mbeten të pa ndryshuara gjatë periudhës raportuese, megjithëse vazhdojnë që drejtpërdrejtë të ndikojnë punën e OShC-ve dhe ambientin ku ato veprojnë.

**Udhëzuesi i Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim për përkrahjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit 2014 – 2020**, si një reflektim i rritjes së rëndësisë që Komisioni Europian i jep rolit dhe zhvillimit të shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, është përdorur nga KCSF si dokument bazë për këtë kontribut. Udhëzimet e Komisionit Europian (KE) përcaktojnë kornizën strategjike për përkrahjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit, të cilat duhet të fokusohen në mundësimin dhe stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse. Udhëzimet e KE-së përmbajnë një numër të objektivave të rëndësishme për tu arritur. Këto objektiva vendosin standardet kundrejt së cilave KCSF ka përgatitur komentet dhe rekomandimet e veta.

Organizatrat e shoqërisë civile nga vendet e zgjerimit kanë qenë të përfshira dhe të konsultuara nga afër gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti strategjik të përgatitur nga DP për Zgjerim. Për më tepër, Udhëzuesi është bazuar kryesisht në **Matricën e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile**, përgatitur nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN). Duke qenë anëtare e BCSDN-së, KCSF ka kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin dhe zbatimin e këtij dokumenti.

Si rezultat, pjesa më e madhe e kontributit të shkruar është e bazuar në **Raportin për Matricën Monitoruese për Kosovën 2013**, e cila ishte e bazuar në një sasi të madhe të të dhënave, hulumtimit dhe treguesëve. Në mënyrë që të mos ngarkohet ky kontribut, nuk ka referenca të veçanta dhe burime për informacionet e ofruara. Megjithatë, të gjitha referencat e veçanta dhe burimet e informacioneve mund të gjenden në Raportin për Matricën Monitoruese për Kosovën 2013, që është në dispozicion në këtë vegëz:

[http://kcsfoundation.org/repository/docs/Kosovo\\_CSDev\\_Matrix\\_Final\\_alb.pdf](http://kcsfoundation.org/repository/docs/Kosovo_CSDev_Matrix_Final_alb.pdf).

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
2.1 Demokracia dhe sundimi i ligjit	3. Shoqëria Civile dhe institucionet publike punojnë së bashku në partneritetet përmes dialogut dhe bashkëpunimit.	Bashkëpunimi në mes OShC-ve dhe institucioneve publike (niveli qeveritar).	<p>Zbatimi i <b>Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, e miratuar në korrik të vitit 2013</b>, ka qenë shumë i ngadalshëm. Megjithëse Plani i Veprimit përfshin kostot e vlerësuara për secilin nga aktivitetet e planifikuara, deri më tani Qeveria nuk ka ndarë buxhet për zbatimin e tij. Në prill 2014, Qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e Këshillit për Zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërisë civile. Këshilli ka 29 anëtarë, 14 përfaqësues të ndryshme të Qeverisë dhe 15 përfaqësues të shoqërisë civile. Procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesëve të shoqërisë civile është duke vazhduar, përmes nominimit dhe votimit të hapur, menaxhuar nga Platforma CIVIKOS.</p> <p>Lidhur me <b>organizimin institucional për bashkëpunim me shoqërinë civile</b>, pas miratimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) është ngarkuar të shërbejë si Sekretariat i Këshillit për zbatimin e Strategjisë, përveç detyrës paraprake të lehtësimit të dialogut mes Qeverisë dhe shoqërisë civile. Ndërkohë që kjo detyrë është vetëm një nga detyrat e shumta të kësaj zyre, ZQM/ZKM nuk ka burime financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për të lehtësuar dialogun OShC – Qeveri, si dhe për të shërbyer si një sekretariat për Këshillin.</p> <p>Si përfundim, Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile e aprovuar së fundmi siguron një kornizë gjithëpërfshirëse të përmirësimit të ambientit për zhvillimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimit në mes Qeverisë dhe shoqërisë civile, mirëpo, organizimi i tanishëm institucional, dhe burimet njerëzore dhe</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Duhet të ketë fonde specifike të ndara për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe edukim të vazhdueshëm dhe ngritje të kapaciteteve për shërbyesit civil për këtë Strategji dhe rolin e tyre në zbatimin e saj.</li> <li>Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit duhet të themelojë një njësi të veçantë për bashkëpunim me shoqërinë civile, me mandat të lehtësimit të bashkëpunimit Qeveri-OShC, si dhe të investojë në kapacitetet e saj njerëzore dhe financiare.</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
		Konsultimi me shoqërinë civile për ligjet/aktet nënligjore, strategjitë dhe reformat politike.	<p>financiare aktuale nuk garantojnë zbatimin e duhur.</p> <p>Korniza ligjore për <b>përfshirjen e OShC-ve në vendim-marrje në nivelin qeveritar</b> siguron shumë mundësi për kontribut nga OShC-të, por mangësitë në zbatimin e duhur dhe mungesa e standardeve konkrete e pamundësojnë dhënien e kontributit nga OShC-të në kohën e duhur. Konkretisht, Rregullorja e Punës e Qeverisë kërkon konsultime publike për të gjitha draft-politikat/ligjet, me informata të përshtatshme dhe në kohë që duhet të sigurohet nga autoriteti propozues, si dhe informata kthyesë për rezultatin e konsultimeve. Megjithatë, vetëm 29.29% e OShC-ve kanë deklaruar që kanë qenë rregullisht të ftuara për konsultime për ligje/politika relevante me punën e tyre, në të gjitha nivelet e qeverisjes. Mungesa e gatishmërisë politike për të përfshirë shoqërinë civile në shumë precesse politike dhe legislative ku interesat e mëdha politike dhe/ose ekonomike janë në pyetje vazhdon të jetë një nga arsyet kryesore për mangësitë në procesin e konsultimeve publike.</p> <p>Për më tepër, Qeveria dhe institucionet e tjera publike tashmë shumë vite nuk kanë qenë të gatshme të trajtojnë çështjen e kapaciteteve njerëzore dhe financiare, duke qenë që nuk ka ndonjë program edukimi/trajnim për shërbyesit civil në këtë temë.</p> <p>Legjislacioni lejon, mirëpo nuk i obligon institucionet publike <b>t'i përfshijnë përfaqësuesit e OShC-ve në trupa të vendim-marrjes apo këshilluese të krijuara nga ana e institucioneve publike</b>. Përfaqësuesit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Legjislacioni duhet të kompletohet me Standardet Minimale për konsultime publike në nivelin qeveritar, të cilat duhet të mbulojnë të gjithë ciklin e vendim-marrjes, duke filluar që nga caktimi i agjendës deri të riformulimi i politikave/ligjeve.</li> <li>Mekanizmat e përgjithshëm të përzgjedhjes duhet të jenë të dizajnuar ashtu që të lejojnë të gjitha institucionet publike t'i aplikojnë me përshtatje specifike.</li> <li>Qeveria duhet të ndajë fonde të mjaftueshme për të ndërtuar kapacitetet e shërbyesëve civil për procesin e konsultimeve publike, si dhe të bashkëpunojë me shoqërinë civile në dizajnimin dhe zbatimin e programeve edukative/trajnimeve për shërbyesit civil në këtë fushë.</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>e OSHC-ve marrin pjesë në shumë trupa ndërsektorial mirëpo përzgjedhja e tyre rrallëherë bëhet bazuar në kritere dhe procese të definuara qartë. Sa i përketë kësaj çështje, nuk ka udhëzues apo mekanizma standard të përzgjedhjes që do të siguronin përfaqësimin të duhur të shoqërisë civile.</p> <p><b>Këshilli Kombëtar për Integrim Europian</b> është themeluar në vitin 2012 me qëllim të drejtimit të vendit në rrugën e reformave komplekse të cilat nevojiten për t’iu afruar BE-së. Edhe pas dy vite të punës Këshilli nuk është duke e përmbushur misionin e tij. Përfundimet e hulumtimit të KCSF-së<sup>1</sup> tregojnë se Këshilli i themeluar për të udhëhequr këtë proces është i ndarë, i ndikuar nga politikat ditore, si dhe i menaxhuar në mënyrë joefektive dhe jotransparente në punën dhe komunikimet e veta.</p> <p><b>Strategjia Kombëtare për Integrimin Europian “Kosova 2020”</b> është përfunduar në qershor të vitit 2013. Draft-strategjia është prezantuar për diskutim dhe miratim në Këshill; megjithatë, nuk ka kaluar përmes procesit të konsultimeve publike në pajtueshmëri me dizpozitat ligjore në fuqi. Në kohën e shkrimit të këtij kontributi, Strategjia nuk ka pronësi dhe asgjë nuk është ndërmarrë për zbatimin e saj.</p> <p>Një numër i dokumenteve strategjike sigurojnë bazë të mirë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Gjithashtu, një grup i organeve të</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshilli ka caktuar një vizion strategjik dhe tani duhet të fokusohet në ndërtimin e konsensusit dhe gjithëpërfshirjes përreth këtij vizioni.</li> <li>• Këshilli duhet të krijojë një sistem për mbikëqyrjen e punës së vet, me qëllim të vlerësimit nëse anëtarët e Këshillit i zbatojnë përfundimet dhe rekomandimet.</li> <li>• Këshilli duhet të respektojë Rregulloren e vet të Punës gjatë thirrjes së mbledhjeve, ndarjes së procesverbalit dhe përfundimeve dhe komunikimit me publikun, me qëllim të përmirësimit të rezultatit dhe performancës së tij.</li> <li>• Strategjia Kombëtare për Integrimin Europian duhet të bëhet dokumenti kryesor udhëzues për të gjitha</li> </ul>

<sup>1</sup> “Bashkëfajtorë në mospunë” – Analizë e punës së Këshillit Kombëtar për Integrim Europian në Kosovë. Në dispozicion në këtë vegëz: <http://www.kcsfoundation.org/?page=1,6,219>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>nivelit më të lartë do të mund të përfitonin nga përfshirja e shoqërisë civile. Megjithatë, si rezultat i menaxhimit të dobët dhe mangësive në zbatim, asnjë dokument por as ndonjë strukturë nuk paraqet ndonjë mundësi frytëdhënëse për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhënien e kontributit dhe monitorimin e agjendës europiane të Kosovës.</p>	<p>përpjeket tjera; për këtë kjo Strategji duhet të ketë pronësi dhe të fillojë së zbatuari menjëherë.</p>
		<p>Konsultimet me shoqërinë civile për agjendën e BE-së.</p>	<p>Negociatat për MSA-në dhe zbatimin i Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave si procese strategjike përplot me kërkesa për reforma të politikave janë zhvilluar pa konsultime ose bashkëpunim me OShC-të. Ngjashëm, përveq përkrahjes së drejtpërdrejtë për OShC-të (programimi i së cilës është konsultuar me OShC-të), gjatë periudhës raportuese nuk kanë ndodhur konsultime me OShC-të sa i përket programimit të fondeve të IPA-s.</p> <p><b>Negociatat për MSA</b> janë zhvilluar prapa dyerëve të mbyllura, duke u konsideruar çështje ekskluzive e Qeverisë. Arsyetimet e zakonshme kanë qenë që negociatat janë në një fazë kritike, që draftet përmbajnë informata të ndjeshme, por edhe që Komisioni Europian ka propozuar që dokumentet të mbahen larg nga publiku dhe OShC-të. Në një tentim për të konsultuar OShC-të për negociatat për MSA-në më 23 dhjetor 2013, pas kërkesës së KCSF-së që para mbajtjes së takimit MIE të ndajë draft-marrëveshjen, sipas Nenit 32 të Rregullores së Punës të Qeverisë 09/2011, mbledhja u anulua. Që nga atëherë, as edhe marrëveshja e sigluar e MSA-së nuk është publike.</p> <p><b>Zbatimi i Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave</b> është përcjellur poashtu me mungesë të bashkëpunimit me OShC-të. Për më shumë,</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeveria duhet të inkurajohet për të bashkëpunuar dhe konsultuar OShC-të gjatë Negociatave për MSA-në dhe zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave.</li> <li>• Qeveria duhet të bëjë publike Marrëveshjen e sigluar të MSA-së dhe të lejojë OShC-të të monitorojnë zbatimin e saj, sapo kjo marrëveshje të nënshkruhet.</li> <li>• Qeveria duhet të bëjë publik kontributin për zbatimin e Udhërrëfyesit, në mënyrë që të lejojë OShC-të të monitorojnë dhe të ndërtojnë besimin e publikut në këtë proces.</li> <li>• Qeveria duhet të bashkëpunojë me OShC-të në mënyrë të strukturuar për të informuar publikun rreth dialogut për vizat.</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>raportimi për zbatimin e Udhërrëfuesit është karakterizuar me mungesë të transparencës. Dokumenti i vetëm për t'iu referuar ka qenë Raporti i Vlerësimit i KE-së i 12 shtatorit 2013. Gjatë periudhës raportuese, as kontributi i Qeverisë dhe as Raportet e Misionit të Vlerësimit të KE-së nuk kanë qenë të qasshme për OShC-të. Vetëm në fund të korrikut 2014 kur KE publikoi raportin e dytë vlerësues (18 muaj pas raportit të parë) OShC-të mund të bënin vlerësimin zbatimit të kriterëve të Udhëzuesit. Në disa raste, kur KCSF ka kërkuar të ndahen më shumë informata në mes periudhave të publikimit të Raportëve të KE-së, anëtarët e misionit vlerësues dhe Zyra e BE-së në Kosovë orientuan OShC-të të kërkojnë informatat në fjalë nga Qeveria, ndërsa përgjigja e Qeverisë ka qenë që KE nuk ka lejuar ndarjen e raporteve me OShC-të.</p> <p>Kjo qasje, edhe gjatë negociatave për MSA dhe gjatë procesit për liberalizimin e vizave, nuk ka ofruar bazë për kontribut të shoqërisë civile dhe monitorim të procesit të Integritimit European në Kosovë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qeveria duhet të konsultojë OShC-të përgjatë programimit të fondeve të IPA-s, veçanërisht gjatë programimit vjetor të fondeve të IPA-s, sipas fushave specifike sektoriale.</li> </ul>
2.2 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave.	1. Ambianti i përshtatshëm ligjor dhe politik për ushtrimin e lirisë së asociimit.	Liria e asociimit	<p><b>Liria e asociimit</b> është e drejtë kushtetuese, e garantuar me Nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe e definuar me Ligjin nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare. Format ligjore përmes së cilave ushtrohet kjo drejtë janë shoqatat dhe fondacionet (bazuar në Ligjin për OJQ-të), si dhe sindikatat, partitë politike, shoqatat e punëdhënësve, komunitetet fetare, etj të cilat janë të rregulluara me ligjet e tyre përkatëse. Megjithatë, nuk ekzistojnë dispozita ligjore për krijimin e kompanive jofitimprurëse apo fondeve investive (<i>endowments</i>), edhe pse kjo e fundit nuk është as e ndaluar</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kapacitetet e Departamentit për Regjistrimin e OJQ-ve duhet të rriten për të interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të rregullt Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ.</li> <li>Ligji ekzistues për Lirinë e Asociimit nuk duhet të ndryshohet deri sa të bëhet një rishikim ligjor dhe një raport</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>dhe as nuk e lejuar në mënyrë eksplicite.</p> <p>Regjistrimi nuk është i obligueshëm, edhe pse shumica e organizatave vendosin të regjistrohen në mënyrë që të kenë personalitet juridik. Rregullat e regjistrimit janë të thjeshta dhe pa pagesë dhe shumica e OShC-ve janë regjistruar brenda afatit të caktuar ligjor, edhe pse ka raste kur ky afat nuk është respektuar, zakonisht si pasojë e kërkesave për dokumente shtesë ose ndryshimeve në statut. Edhe pse procesi i regjistrimit konsiderohet lehtë i qasshëm dhe pa ndonjë barrë të papërbalueshme, ka raste kur Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve kërkon dokumente shtesë, të cilat nuk janë as kërkesa ligjore dhe as të bazuara në ndonjë dokument ose standard ndërkombëtar. Legjislacioni lejon procesin e ankesave dhe ekziston një udhëzim administrativ për procesin e ankesave. Sidoqoftë, është problematike që autoriteti i njejtë është i mandatuar për të themeluar këtë komision. Përveç kësaj, nuk ekzistojnë rregulla për funksionimin e këtij komisioni. Pjesa më e madhe e problemeve gjatë fazës së regjistrimit vijnë si pasojë e mungesës së kapaciteteve të nevojshme dhe keqkuptimit të kërkesave ligjore nga Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve/Ministria e Administratës Publike, i cili është autoriteti i vetëm përgjegjës për regjistrimin e OJQ-ve.</p> <p>Gjatë periudhës raportuese, ka filluar një <b>iniciativë nga Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve për ndryshimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit</b>, duke synuar të jepjen kompetenca monitoruese dhe</p>	<p>gjithëpërfshirës i zbatimit, në mënyrë që të identifikohen zbrazëtitat eventuale si në kornizën legislative, ashtu dhe në zbatim, dhe në përputhje me të gjeturat të adresojen çështjet që duhet të përmirësohen.</p>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			mbikëqyrëse për Departamentin për Regjistrimin e OJQ-ve, si dhe harmonizimin e Ligjit për OJQ-të me Ligjin për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Përveç kësaj, procesi i ndryshimit të Ligjit synon të përfshijë sanksione për shkeljen e një numri të neneve specifike të Ligjit në fuqi dhe procedurë civile, administrative ose penale në rast të suspendimit ose revokimit të Statusit për Përfitim Publik. Kjo iniciativë nuk ka qenë e bazuar në ndonjë vlerësim ligjor ose vlerësim të zbatimit të ligjit ekzistues, kështu që nuk kontribuon në avancimin e Ligjit për OJQ-të në raport me nevojat e tanishme për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.	
		Legjislacioni që ndërlidhet me shoqërinë civile	Gjatë periudhës së raportimit, OShC-të kanë paraqitur shqetësimet e tyre për kufizimet për OShC-të në <b>legjislacionin për ndalimin e pastrimit të parave dhe anti-terrorizmit</b> . Çështjet kryesore shqetësuese në lidhje me Ligjin 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit janë: ndërsa të gjithë sektorët e tjerë duhet vetëm të informojnë autoritetin kompetent (Njësia e Inteligjencës Financiare) për pagesat përtej pragut të caktuar (zakonisht 10.000 euro), OJQ-të nuk janë të lejuara të marrin ose të japin pagesa përtej kufijve mjaft të ulët (1.000 euro, respektivisht 5,000 euro nga një burim/marrës i vetëm brenda një dite). Lirimi nga këto ndalesa paraqet barrë për OJQ-të dhe është pa kritere të veçanta, dhe përgjigja mund të vonohet deri në 30 ditë, periudhë gjatë së cilës OJQ-të nuk mund të ekzekutojnë transaksionet financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit duhet të ndryshohet në mënyrë që të largohen dispozitat kufizuese për OJQ-të, paralelisht me garantimin e sigurisë publike. Shoqëria civile duhet të përfshihet në procesin e ndryshimit të Ligjit, në mënyrë që Ligji i ri të ketë parasysh natyrën specifike të punës së sektorit të shoqërisë civile.</li> <li>• Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për Bankat, Institucionet</li> </ul>



Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>përkatese. Për më tepër, dështimi për të respektuar këto kufizime konsiderohet vepër penale dhe dënohet me burgim deri në 2 vite. Problemet e tjera të ligjit janë të lidhura me konflikt ligjor me ligjin bazë për OJQ-të në heqjen e regjistrimit të OJQ-së, si dhe futjen e kompetencave të monitorimit dhe inspektimit për Departamentin për Regjistrimin e OJQ-ve.</p> <p>Me vendimin e saj të 12 prillit 2013 për Ligjin për Banka, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi të gjitha dispozitat në Ligjin për Banka të cilat mundësonin transformimin e OJQ-ve mikrofinanciare. Pas këtij vendimi, një <b>draft-ligj për Institucionet Mikrofinanciare</b> është duke u hartuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Si përgjigje në një ftesë për komente nga Guvernatori i Bankës Qendrore (BQK) në janar 2014, KCSF në emër të një grupi më të gjerë të OJQ-ve të interesuara për këtë rast, ka paraqitur komente të shkruara, një analizë ligjore dhe rekomandime konkrete në draft-ligjin fillestar të propozuar nga BQK. Kërkesa kryesore e OJQ-ve ka qenë zbatimi i plotë i vendimit të Gjykatës Kushtetuese gjatë hartimit të këtij draft-ligji. KCSF ka theksuar që drafti fillestar ka një numër të dispozitave që në mënyrë të tërthortë lejojnë këtë transformim, përkatësisht janë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, procesi i hartimit të këtij draft-ligji ka disa probleme procedurale: përderisa Qeveria konfirmoi që Ministria e Financave do të jetë organ propozues i këtij ligji, BQK deklaroi që hartimi ishte autorizuar nga</p>	<p>Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (i datës 12 prill 2013) për çështjen e transformimit të OJQ—ve Mikrofinanciare duhet të respektohet gjatë hartimit të Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare.</p>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa. BQK nuk i është përgjigjur komenteve të dërguara nga KCSF dhe ne nuk kemi informacion zyrtar për gjendjen aktuale të procesit të hartimit.	
	2. Ambient financiar i përshtatshëm që mbështet qëndrueshmërinë e OShC-ve.	Rregullat financiare për OSHC-të që janë lehtë të zbatueshme.	Në përgjithësi, OShC-të funksionojnë lirshëm pa ndonjë ndërhyrje të paarsyeshme nga institucionet në qeverisjen e brendshme dhe aktivitetet e tyre. <b>Kërkesat e përgjithshme të raportimit</b> janë të dyfishta: raportimi në Administratën Tatimore të Kosovës për transaksionet financiare dhe raportimi në Departamentin e Regjistrimit të OJQ-ve për Organizatat me Status të Përfitimit Publik. Kërkesat e raportimit për Administratën Tatimore janë identike me ato për biznese dhe 53,94% e OShC-ve i konsiderojnë këto kërkesa si jo në përputhje me natyrën specifike të punës së OShC-ve. Raportimi në Departamentin e Regjistrimit të OJQ-ve për Organizatat me Status të Përfitimit Publik është shumë formal, ndërsa informacioni i mbledhur përmes këtij kanali nuk shfrytëzohet.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Korniza ligjore për raportim financiar të OShC-ve duhet të prezantojë një sistem që merr parasysh natyrën specifike të OShC-ve.</li> </ul>
		Nxitja e donacioneve	Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Ligji për tatimin në të ardhurat personale ofrojnë <b>zbritje të tatimeve për korporata ose individë</b> deri në 5% të të ardhurave të tyre të tatueshme për donacione për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtjen e mjedisit apo qëllime sportive. Përfituesit e ligjshëm të donacioneve përfshijnë OJQ-të të cilat kanë përfituar Statusin për Përfitim Publik nga ligji bazs dhe ndonjë organizatë tjetër jo-komerciale që drejtpërdrejtë zbaton aktivitete në	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemi dhe legjislacioni për lirim nga tatimet për donacionet individuale dhe të korporatave duhet të reformohet duke pasur parasysh shkallën dhe qëllimin e liritimit dhe zbatimit të mekanizmave të tij.</li> <li>Legjislacioni tatimor duhet</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>interes të publikut dhe jo-për-përfitim nga fushat e cekura më lart. Ky përfitim nga taksat parashikohet vetëm për një numër të caktuar të aktiviteteve me interes publik, dhe në këtë mënyrë nuk është koherent me statusin për përfitim publik i cili është përcaktuar në ligjin bazë për OJQ-të. Në praktikë, gjatë periudhës raportuese pak OJQ kanë pranuar donacione individuale ose nga korporatat, por asnjë nga këto raste nuk ka deklaruar që zbritja e taksave të ketë qenë shtysë për këto donacione. Kjo nënkupton që përfitimet tatimore nuk janë shtyesi kryesor për donacione. Përgjegjësia Shoqërore e Korporatave (PSK) nuk është koncept shumë i përhapur ndër kompanitë private në Kosovë dhe rastet e rralla të PSK janë të kryesisht të iniciuara në baza individuale, pa ndonjë politikë shtetërore për PSK. PSK nuk promovohet as nga shteti e as nga sektori i biznesit apo OShC-të.</p>	<p>harmonizuar në mënyrën më të plotë të mundur me kapitullin për Statusin për Përfitim Publik në Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ.</p>
		Lehtësirat tatimore për OShC-të	<p>Korniza ligjore ofron <b>lehtësira tatimore për një numër të të ardhurave të OShC-ve</b>, megjithëse efekti i tyre në praktikë është i kufizuar. Grantet dhe donacionet për mbështetjen e aktivitetit jo-për-përfitim të OJQ-ve nuk taten, dhe nuk ka raporte të ndonjë tatimi në burimet e tilla të të ardhurave. Sa i përket aktivitetit ekonomik, ka paqartësi në kornizën ligjore, në veçanti për aktivitetet ekonomike të OShC-ve të cilat nuk kanë status të përfitimit publik. "Një organizate joqeveritare e cila ndërmerr aktivitete komerciale ose aktivitete të tjera që nuk janë të lidhura me qëllimin e saj publik, i caktohet tatimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi dhe legjislati i për lehtësira tatimore nga burimet e të ardhurave të OShC-ve duhet të reformohet duke pasur parasysh shkallën dhe qëllimin e lirit nga tatimet dhe zbatimin e mekanizmave të tij.</li> <li>• Duhet të fillojë hartimi i kornizës ligjore për kompanitë jo-për-përfitim dhe fondeve investive (<i>endowments</i>),</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>në të ardhura ...", ndërsa aktivitetet ndërlidhura ekonomike të OShC-ve janë të liruara nga taksat deri në "një nivel të arsyeshëm të të ardhurave". Konkretisht, aktiviteti ekonomik i ndonjë OJQ-je të regjistruar duhet të jetë drejtpërdrejtë i lidhur me misionin e saj, dhe të gjitha aktivitetet e tjera ekonomike i nënshtrohen tatimit në të ardhura. Nivel i arsyeshëm i të ardhurave janë të ardhurat të cilat sigurojnë qëndrueshmëri dhe zhvillim të OJQ-së. Sidoqoftë, përderisa Ligji 03/L-162 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave mund të interpretohet që të gjitha organizatat joqeveritare i nënshtrohen përfitimit tatimor për aktivitetet e ndërlidhura ekonomike, Udhëzimi Administrativ përkatës nr. 14/2010 që bën sqarimin e zbatimit të këtij ligji flet vetëm për organizatat me status të përfitimit publik. Kjo mospërputhje shkakton vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e tij, megjithëse një numër i OShC-ve lirohen nga tatimet për aktivitetet e tyre ekonomike.</p> <p>Nuk ka dispozita të qarta për përfitimet tatimore për <b>investimet pasive</b> të OShC-ve, ndërsa investimet pasive nuk janë të zakonshme në mesin e shoqërisë civile në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka dispozita për <b>krijimin dhe funksionimin e fondeve investive (endowments)</b>. Nuk janë hasur praktika të themelimit ose veprimit të fondeve investive në Kosovë.</p>	<p>dhe funksionimi i tyre duhet të rregullohet në mënyrë të qartë.</p>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
		<p>Fondet publike për OShC-të (transparenca, paanësia dhe jo-diskriminimi; Shuma e fondeve publike në dispozicion për OShC-të; cilësia (procedurat) e kornizës së financimit publik.</p>	<p>Nuk ka ligj të veçantë apo politikë kombëtare për rregullimin e <b>përkrahjes shtetërore për OJQ-të</b>, njejtë siq nuk ekzistojnë mekanizma për shpërndarjen e <b>fondeve publike për OShC-të</b> në nivel kombëtar ose lokal. Nuk ka financim publik për zhvillim institucional të OShC-ve dhe bashkëfinancim të projekteve të BE-së dhe granteve tjera, përderisa mbështetja e projekteve është prezente në disa raste, kryesisht në nivel lokal. Në praktikë, pjesa e fondeve publike për shoqërinë civile është rritur nga 8% në vitin 2010 në 20% të burimeve të përgjithshme të shoqërisë civile në vitin 2013. Këto fonde për OShC-të janë shpërndarë nga institucionet specifike në nivel lokal dhe qendror, pa ndonjë koordinim ose koherencë. Këto fonde nuk janë të planifikuara brenda buxhetit shtetëror dhe vetëm katër raste të planifikimit të veçantë për mbështetje të projekteve të OShC-ve janë identifikuar në buxhetin e vitit 2014 në nivel lokal dhe qendror. Për ilustrim, linjat e veçanta buxhetore për OJQ janë këto: OJQ-të në Rahovec do të mbështeten me 8.000 euro për çështje sociale dhe 15.000 euro për projekte të zhvillimit rural; në Istog një linjë buxhetore me 15.000 euro është e dedikuar për pjesëmarrje në projekte kapitale përmes OJQ-ve, komunitetit ose donatorëve të tjerë, përderisa projektet e OJQ-ve lokale në Kamenicë do të mbështeten me 25.000 euro.</p> <p>Ligji Nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit ofron mundësinë që një pjesë e fondeve të Lotarisë së Kosovës të drejtohen për kategoritë e ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport. Detajet për tranfere të tilla do të duhej të përcaktoheshin nëpërmjet një Udhëzimi Administrativ, por një udhëzim i tillë nuk është hartuar ende dhe nuk ka raporte që fonde të tilla janë mbledhur ose</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të iniciohet një sistem gjithëpërfshirës për fondet publike, në bazë të objektivave të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe kriteret, standardet dhe procedurat e planifikuara duhet të sigurojnë zbatimin transparent dhe të përgjegjshëm të fondeve publike për OShC-të.</li> <li>• Pavarësisht dizajnit të sistemit gjithëpërfshirës të financimit publik për shoqërinë civile, të gjitha informatat mbi fondet publike të ndara për OShC-të duhet të bëhen transparente menjëherë.</li> </ul>

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>shpërndarë. Ministria e Financave nuk është në gjendje të ofrojë ndonjë <b>të dhënë për fondet e shpërndara te OShC-të</b>. Në përgjigjen e një kërkesë zyrtare për informata për këtë çështje, Ministria e Financave theksoi që Ligji për Buxhetin nuk ka ndonjë ndarje të drejtpërdrejtë ose linjë të veçantë buxhetore për organizatat joqeveritare. Kjo konfirmon që financimi nuk është i planifikuar dhe i parashikueshëm dhe shuma e fondeve publike të ndara për OShC-të është e pamundur të identifikohet. Buxhetimi me pjesëmarrje nuk është i zakonshëm në Kosovë, OShC-të nuk janë pjesë e ciklit të buxhetimit publik, as për fondet publike për shoqërinë civile.</p> <p>Nuk ka <b>procedura të veçanta për shpërndarjen e fondeve publike te OShC-të</b>, përfshirë mungesën e kriterëve të përzgjedhjes të cilat do të siguronin që fondet publike jepen në mënyrën e përcaktuar. Si pasojë e mungesës së planifikimit të veçantë buxhetor dhe informatave për përzgjedhje, është shumë e vështirë të mblidhet informacion i saktë për shumën, tipin e projekteve dhe organizatave që përfitojnë nga fondet publike. Ka pak informacion të qasshëm për publikun rreth kushteve për aplikim, ndërsa shumica e vendimeve për financim nuk janë transparente. Procedurat e vetme specifike për paraqitjen e konfliktit të interesit për OShC-të janë të lidhura me zyrtarët publik si anëtarë të bordeve të OShC-ve në raport me fondet shtetërore, megjithëse nuk ka në dispozicion informacion mbi ndershmërinë e financimit dhe ndonjë konflikt eventual të interesit.</p> <p>Nuk ka <b>sistem të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimit publik të OShC-ve</b>. Nuk ka procedura për sigurimin e llogaridhënies, përderisa monitorimi dhe vlerësimi i fondeve publike</p>	

Referenca në Raport të Progresit	Pikat e referimit (Objektivat e Udhëzuesit të KE për shoqërinë civile)	Fusha e vlerësimit	Kontributi i KCSF-së/Komentet:	Rekomandimet:
			<p>është i rregulluar vetëm me dispozitat e përgjithshme të Ligjin për Prokurim Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ligje këto që nuk marrin parasysh natyrën specifike të punës së OShC-ve. Zakonisht nuk raportohet për vizita monitoruese nga autoritetet kontraktuese, dhe në ato raste kur bëhen, nuk ka procedura të standardizuara ose aktivitete pasuese nga vizitat e tilla. Pasi nuk ekzistojnë dispozita të veçanta ligjore, sanksionet për keqpërdorimin e fondeve publike nga OShC-të janë të njëjta me të gjitha subjektet e tjera ligjore, kështu që nuk merret parasysh proporcionaliteti i sanksionit në raport me madhësinë dhe llojin e organizatave të shoqërisë civile. Për fund, duke qenë të shpërndara në baza <i>ad-hoc</i> dhe në mënyrë të pastandardizuar, nuk ka informata që është ndërmarrë ndonjë vlerësim për fondet publike për OShC-të.</p>	